



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



Komuna e Istog  
Opština Istok  
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

---

## KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINË/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

---

### PROCESVERBAL

Nga mbledhja e tridhjetë e tetë e rregullt e Legjislacionit të VII-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: **30.05.2025**, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora **10:00**.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

1. Enver Rugova, LDK;
2. Hajrush Shoshi, LDK;
3. Faruk Kabashi, LDK;
4. Haki Podrimaj, LDK;
5. Faik Alushaj, LDK;
6. Arta Balaj, LDK;
7. Liridona Lajçi, LDK;
8. Valbona Demaj, LDK;
9. Ruzhdi Metaj, LDK;
10. Arianit Selmanaj LDK;
11. Agron Gashi, AAK;
12. Ajshe Metaj, AAK;
13. Ardita Idrizaj, AAK;
14. Fjolla Ukaj, AAK;
15. Negjdet Ramaj, AAK;
16. Nexhmedin Balaj AAK;
17. Niman Beqiraj, VV
18. Florin Dreshaj, VV;
19. Floriana Maxharraj, VV;
20. Lavdije Bujupaj, VV;
21. Arian Shatri VV;
22. Andi Xhuraj PDK;
23. Visar Haxhijaj, PDK;
24. Era Visoqi, PDK;
25. Djula Karisik, GIBI;

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm Kryetari i komunës Ilir Ferati, NënKryetari i Komunës Ali Nimanaj Drejtoret e Drejtive, zyrtarë administrativ si dhe media lokale RTV - Fontana, përfaqësues të GIZI-it (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe e njëjtë gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe CD-te e xhirimit gjenden në dosje: "shembulli 2").

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar dhe publikuar drcjtpërdrejt në

<https://www.youtube.com/watch?v=Isj4tfWLGhs>

<https://www.youtube.com/watch?v=zZr1s-UIY2w>

<https://www.youtube.com/watch?v=vxj9HLQUhD4>

"shembulli 3").

Procesverbali

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Enver Rugova.

**Kryesuesi i Kuvendit-** përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje.  
Hap punimet për mbledhjen e tridhjetë e tetë të rregullt të Legjislacionit të VII-të  
dhe për këtë mbledhje propozoi këtë rend dite:

**Konstaton Kuorumin për mbajtjen e mbledhjes në bazë të listës së nënshkrimeve dhe prezencës në sallë, prezentë janë 25 të anëtarë të Kuvendit.**

Vazhdojmë me mbledhjen :

#### R e n d   d i t e

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Njoftimi me Qarkoren Buxhetore nr.1 të Ministrisë së Financave për kufijtë preliminar të përgatitjes së Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Komunale,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim Vendimit për Destinimin e parcelës për varreza në fshatin Zhakovë,
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (PNMIM) për pesë komunat e rajonit të Dukagjinit, Pejë, Klinë, Istog, Deçan dhe Junik 2025-2035,
7. Shqyrtimi dhc miratimi i Listës së projekteve kapitale në bashkëfinancim me komunitetin për vitin fiskal 2025,
8. Të ndryshme.

**Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Floriana Maxharraj.**

**Floriana Maxharraj-** propozoj këtë pikë për rend dite, Lirim i nga pagesa e punonjësve të Zjarrëfikësve nga shërbimet që ofrohen në Qendrën e Mjekësisë Familjare. Kjo do të jetë vetëm një akt mirënjojje ndaj punës së tyre, kërkoj mbështetjen e ekzekutivit dhe të kolegeëve, ju faleminderit!

**Kryesuesi i Kuvendit- në rregull Floriana. Fjalën e ka Negjdet Ramaj.**

**Negjdet Ramaj-** kam një kërkesë për kryetarin dua ta di çfarë po ndodhë me draft Rregulloren për emërimin e institucioneve komunale, na ka premtuar që do të vjen mbledhjen e ardhshme. Desha ta di pse nuk e kemi si pikë të rendit të ditës për sot që të shpallet për diskutim publik.

**Kryesuesi i Kuvendit-** fjalën e ka Kryetari i Komunës.

**Kryetari i Komunës-** pëshëndet të gjithë të pranishmit! Për shkak se grupei punues ende është duke punuar Negjdet. Është diçka komplet e re, nuk ka praktika as nëpër komuna të tjera. Është problemi i njejtë sit e Rregullorja për Tregun tërë ditor se është e re prej zeros. Edhe kjo gjithashtu është e re, do punë është shumë voluminoze. Nuk ka tjetër arsyе absolut fare. Momentin e parë që grupei e finalizon draftin e sjellim në Kuvend dhe vazhdojmë tutje.

**Kryesuesi i Kuvendit-** për dhënien në shfrytëzim të tregut e di që ajo Rregullore është shpallur në diskutim publik dhe sot e kemi për me e votuar, për atë u bë diçka e për këtë jo. Vetëm desha ta di pse në këtë nuk po punohet pasi që është më e rëndësishme se tregu e diçka tjetër. Kisha pasur dëshirë që sa të jemi ne këtu si kuvendarë ta votojmë dhe mos të ju a lëmë pasardhësëve tone obligim ashtu siç e ceku edhe kryetari dhe kisha pas qejf që ne ta përfundojmë sa jemi në këtë mandat.

**Kryetari i Komunës-** sa kam info Negjdet, se jurist nuk jam, edhe Kuvendit edhe Kryetarit në momentin e shpalljes së zgjedhjeve lokale prej Presidentes i zvogëlohen kompetencat në vendimarrje. Por ta kishim pasur të gatshme sot me e votuar nuk kishim pasur mundësi me e arrit ligjërisht me e pasur të drejtën me i emërtuar për shkak se zvoglohen kompetencat. Nuk krahasohet me tregun se është më e ndjeshme, momentin që kompletohet materiali ligjor edhe me akter të tjerë e kryesisht këta ligjor që mos me bërë gabime që mundet dikush me e rrëzuar me një ankesë eventuale sepse po flasim për emërtimin e institucioneve me emra që janë të përjetësuar.

**Kryesuesi i Kuvendit-** fjalën e ka Negjdet Ramaj.

**Negjdet Ramaj-** në bazë të përgjigjes që e dha kryetari, nuk kam se çfarë merrem më me këtë e as kuvendarët tjerë pasi që nuk paskemi kompetenca për këtë mandat. Tani dua ta di a e kemi zvarrit pas këtë punë qëllimi apo ka ndodhur rastësish kjo se ka dy vite e më shumë që e kam propozuar. E prej këndvështrimit tim po më duket që qëllimi e kemi zvarrit.

**Kryetari i Komunës-** secili anëtar i Kuvendit ka të drejtë me e pas këndvështrimit e vet, por kur diskutojmë për emra që janë të përjetësuar, unë nuk besoj që ka këtu qenie njerëzore që me bërë diçka të qëllimshme kundrejt tyre.

**Kryesuesi i Kuvendit-** pyes ekzekutivin a ka diçka në lidhje me rendin e ditës? Fjalën e ka Agon Dreshaj.

**Agon Dreshaj-** pasi që dje kemi mbajtur mbledhjen e Komitetit Për Politikë dhe Financa ku janë propozuar pikat për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale në bazë të shprehjes së interesit, bazuar në vendimin që e kemi marrë në dhjetor të vitit 2024 dhe njoftimit që ka dalë muajin e kaluar. Nga 18 (tetëmbëdhjetë) parcela kemi oferta vetëm për 13 (trempëdhjetë) prej tyre. Propozon pikat për rend dite:

Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për dhëniën në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës e evidentuar sipas njësisë kadastrale nr. 367-0 ZK Kërrninë.

Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për dhëniën në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës e evidentuar sipas njësisë kadastrale nr. 540-0 ZK Veriq.

Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për dhëniën në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës e evidentuar sipas njësisë kadastrale nr. 233-0 ZK Kërrninë.

Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për dhëniën në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës e evidentuar sipas njësisë kadastrale nr. 500-0 ZK Bellopojë.

Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për dhëniën në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës e evidentuar sipas njësisë kadastrale nr. 373-0 ZK Kërrninë.

Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për dhëniën në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës e evidentuar sipas njësisë kadastrale nr. 499-0 ZK Bellopojë.

Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për dhëniën në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës e evidentuar sipas njësisë kadastrale nr. 1428-0 ZK Shushicë.

Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës e evidentuar sipas njësisë kadastrale nr. 368-0 Kërrninë.

Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës e evidentuar sipas njësisë kadastrale nr. 541-0 ZK Veriq.

Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës e evidentuar sipas njësisë kadastrale nr. 372-0 ZK Kërrninë.

Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës e evidentuar sipas njësisë kadastrale nr. 1423-0 ZK Shushicë.

Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës e evidentuar sipas njësisë kadastrale nr. 1420-0 ZK Shushicë.

Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës e evidentuar sipas njësisë kadastrale nr. 1424-0 ZK Shushicë.

**Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Agron Gashi.**

**Agron Gashi-** para se të dalim një nga një te këto pika e kam një vërejtje ashtu siç i kemi dhënë edhe në mbledhjet e kaluara, se tani dy minuta pa u votuar këto pika që janë me vlerë investive shumë të mëdha, dhe ne kuvendarët që e japim votën, del drejtori na tregon se ku janë dhe çfarë janë. Është shumë absurde dhe jo profesionale prej jush ku ne si Kuvend nuk e kemi asnje dokument dhe nuk e dimë as çfarë votojmë.

**Kryesuesi i Kuvendit- drejtor na prezanto pak procesin se si ka shkuar.**

**Agon Dreshaj-** jep një prezantim rreth këtyre propozimeve.

**Kryetari i Komunës-** në rastet kur investimi kalon vlerën prej 10 hektarësh secila kompetencë tjeter përpos dhënies në shfrytëzim të pronës kalon në Ministrinë e Ambientit dhe komisioneve ndë rministrore që janë të nivelit specialistik që i bëjnë vlerësimet.

**Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Agron Gashi.**

**Agron Gashi-** faleminderit për sqarimet drejtor. Ti tregove për procedurat e komisionin, por unë thashë diçka tjetër. Unë si kuvendar duhet me i pasur të pasqyruara kush e ka fituar, sa ka qenë vlera investive, të gjitha është dashur me i pasur në email. Për këtë nuk me je përgjigj dhe nuk ka përgjigje.

#### Kryesuesi i Kuvendit- Florin a deshe me e marrë fjalën.

**Florin Dreshaj-** Lëvizja Vetëvendosje e ka shqetësimin e njejtë sikurse Agroni. Çdoherë kur po ka me dhënë prona po shkon kështu një lloj mjegullie shkcl e shko. Po dalim para aktit të kryer, nuk jemi në gjendje me marrë vendim a me votuar për a kundër, ne jemi për me i dhënë pronat në shfrytëzim dhe këtë e kemi kërkuar me vite të tëra. Kemi kërkuar edhe me u diskutuar për këto prona, por kryetari ka thënë që është duke u zhvilluar një proces gjyqësor dhe nuk kemi të drejtë të diskutojmë për këto prona. Nëse po zhvillohet proces gjyqësor si kemi të drejtë me i dhënë në shfrytëzim. Lëvizja Vetëvendosje për shkak të këtyre veprimeve të ekzekutivit nuk është në gjendje të participoj në këtë pikë dhe kërkojmë me e shty për mbledhjen tjetër që të kemi pak më shumë informacion, as nuk e dimë ku janë ato prona. Faleminderit!

**Kryetari i Komunës-** profesor, pronat janë të kategorisë 5-6-7 e tutje, prona prej të cilave është e pamundur me marrë rendiment bujqësor. Pronat janë të destinuara për ndërtimin e parqeve solare përmes hartës zonale që e kemi votuar dhe trajtuar këtu si dokument e përtej kësaj marrë edhe pëlqimin e ministrisë së Ambientit e një mori ekspertave që e kanë analizuar pothuajse dy vite. Pronat janë shpallur në ankand publik procedurë që i do afatet e veta. Momentin që ndodhë vlerësimi dhe shpallet rezultati prej komisionit prapë e do afatin tjetër të paraqitjes së ankesave. Të gjitha këto afate të bien dje në mbledhjen e Komitetit që është mbajtur pa asnje qëllim të vetëm sepse i keni përfaqësuesit e juaj edhe në Komitet edhe përfaqësuesi i AAK-së sipas fuqisë politike në pjesën e vlerësimit dhe sa di unë janë katër-pesë takime që janë mbajtur, nuk janë kryer ad-hoc por janë kryer në detaje, procedurë për procedurë, ofertë për ofertë në mënyrë që mos me lëshuar asnjë gabim eventual. Nuk ka mjegulli, nuk ka paqartësi. E çka është më e mira e kësaj është që e kemi MAPL-në që verifikon ligjshmérinë e vendimeve që i nxjerrni ju si Kuvend. E për atë që the është zhvilluar një proces gjyqësor nuk është zhvilluar gjyqësor por hetimor.

#### Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Florin Dreshaj.

**Florin Dreshaj-** prapë se prapë edhe pas sqarimit të kryetarit, Lëvizja Vetëvendosje është kundër që me u dhënë këto prona në shfrytëzim ose me qenë sot në rend dite kjo pikë, për shkak se kryetari tanë tha që janë të kategorisë 5-6-7, por si me i besuar fjalës së kryetarit, ka pas mundësi me na sjellë me i pasur në letër me e vërtetuar vet. Nuk e kemi informacionin e mjaftushëm për me pas mundësi me marrë vendim.

**Kryetari i Komunës-** me 23 Prill profesorështë shpallur ankandi me shprehje të interesit publik që i bie 36 ditë më herët se dita e sotme. Në të cilën shprehje të interesit publik kanë qenë të paraqitura parcelat me numrin e tyre. Nëse ka qenë e rëndësishme për Lëvizjen Vetëvendosje pse nuk kanë bërë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare dhe me e vërtetuar se çfarë klase e kanë ato toka.

**Kryesuesi i Kuvendit-** ju garantoj që Kuvendi me gjithë trupat e veta në asnjë moment nuk e ka shkelur asnjë afat ligjor asnjë procedurë se nuk i konvenon askujt me shku me procedura jo të rregullta se shkon në MAPL dhe e rrëzon poshtë. Fjalën e ka Negjdet Ramaj.

**Negjdet Ramaj-** pasi që është investim i madh kapital edhe këto zona janë me shumë interes vetëm desha sëqarim ta di a ka qenë kriteri çmimi më i lartë me i fituar këto prona, apo nëse kanë qenë përfitime të komunës pse atëherë nuk është lexuar çfarë përfiton komuna në momentin e hapjes së ankandit por është lexuar vetëm çmimi i ofertave. Edhe a kemi pasur ankesa sepse kam informacione dytësore që ka pasur ankesë prej "Blakaj Aksa" SH.P.K e cila ka qenë me çmim trefish më të lartë se kompania tjetër që e ka fituar dhe çfarë interes publik kemi ne qytetarë të komunës së Istogut prej një kompanie që oferton 320.00 euro për hektarë ndërsa "Blakaj Aksa" SH.P.K që ka ofertuar diku 1.300.00 euro për hektarë. D.m.th ky ka konkuruar për tri parcela vetëm një e ka fituar mirëpo dy parcelat që janë diku 76 hektarë i merr një kompani tjetër që ofrton me çmim trefish më të ulët. Nëse jemi duke folur për interes publik ne nuk jemi duke i bllokuar këto në asnjë mënyrë, përfitojnë fëmijët tanë për 30 vitet e ardhshme punësohen njerëzit, por nëse është 1.300.00 euro është shumë e madhe. Ankesë ka pasur, por ankesa ju ka hedh poshtë për shkak se afatet ligjore i ka kaluar në bazë të komisionit.

**Agron Dreshaj-** jep sëqarimt e nevojshme.

**Negjdet Ramaj-** unë vetëm kam pasur frikë që nëse palës nuk i merret për bazë ankesa ai ka drejtë me e proceduar në gjykatë dhe mundet me u bllokuar i gjithë procesi. Faleminderit!

**Kryesuesi i Kuvendit-** fjalën e ka Niman Beqiraj.

**Niman Beqiraj-** te çështja e pronave, është çështje e ndjeshme dhe është përgjegjësi e dyanshme edhe e Kuvendit edhe e Ekzekutivit. E rëndësishme për mua si anëtar i Kuvendit komunal nga informatat që i mora prej drejtorit Agonis, për mua është e rëndësishme kush janë investitorët, sa kanë me investuar, çka përfiton komuna, çka përfiton shteti, ekonomika jonë, punësimi, ku janë ato kërkesat për çerdhe, sa ka me qenë çerdhja e madhe, se ne e dimë që çerdhe këtu në Istog që se di sa vite si komunë nuk kemi arritur me e rregulluar e le të vijë dikush, më ka humbur edhe besimi që mundet me u kry diçka. Pa nuk e kemi asnjë informatë. Emrat që i përmendi Agoni të bizneseve, që kanë aplikuar për

këto prona unë i dëgjová prej Agonit. Në material nuk i kam pasur askund. Për mua çshëtë shumë e nevojshme me pasur më shumë informata për me e marrë një vendim.

**Kryesuesi i Kuvendit-** fjalën e ka Andi Xhuraj.

**Andi Xhuraj-** desha një pyetje para se me i votuar për ose jo për rend dite. Ky afati ligjor prej shtatë ditësh që është për ankesa, kisha pasur dëshirë dikush prej ekzekutivit me dalë edhe me na njoftuar se a llogaritet prej ditës së publikimit a prej të nesërmes? Se këtë nuk po e kemi të qartë dhe kishte qenë mirë me dalë dikush e me thënë publikisht para nesh.

**Kryesuesi i Kuvendit-** e sqaroi drejtori prej ditës së publikimit. Fjalën e ka Hajrush Shoshi.

**Hajrush Shoshi-** kisha kërkuar që paraprakisht të shpërndahet materiali, që çdo anëtar i Kuvendit ta ketë si tanë si për më vonë, edhe a vendoset me hy si pikë e rendit të ditës vendoset me vota. Por le ta ketë secili materialin para vtes.

**Kryesuesi i Kuvendit-** fjalën e ka Abedin Kabashi.

**Abedin Kabashi-** propozon një pikë të rendit të ditës 'Kërkesë për bartjen e pronësisë nga Komuna e Istogut te "KMDK SH.A / Kosovo Landfill" Prishtinë me qëllim të investimit të deponisë në Tuqep. Prej përkrahjen e juaj.

Kryesuesi i Kuvendit- a ka edhe dikush diçka? Pasi që jo, po fillojmë me propozimet që i kanë dhënë anëtarët e Kuvendit edhe ekzekutivi. Floriana Maxharraj ka propozuar që njësia e zjarrëfikësve në Istog të lirohen nga shërbimet mjekësore në QKMF Istog? Kush është të hyj kjo në rend dite për sot?

**Konstatojmë** që nga 25 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 25 vota pro 0 kundër dhe 0 abstenim kjo pikë e propozuar nga Floriana Maxharraj hyn në rend dite për mbledhjen e sotme.

**Kryesuesi i Kuvendit-** fillojmë me propozimet që i propozoi drejtori Agon Dreshaj. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës e evidentuar sipas njësisë kadastrale nr. 367-0 ZK Kërrninë. Kush është të hyj kjo në rend dite për sot?

**Konstatojmë** që nga 25 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 19 vota pro 5 kundër dhe 1 abstenim kjo pikë e propozuar hyn në rend dite për mbledhjen e sotme.

**Kryesuesi i Kuvendit-** vazhdojmë me propozimin tjetër ‘Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës e evidentuar sipas njësisë kadastrale nr. 540-0 ZK Veriq . Kush është të hyj kjo në rend dite për sot?

**Konstatojmë që nga 25 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 17 vota pro 5 kundër dhe 3 abstenime kjo pikë e propozuar hyn në rend dite për mbledhjen e sotme.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** vazhdojmë me propozimin tjetër ‘Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës e evidentuar sipas njësisë kadastrale nr. 233-0 ZK Kërrninë. Kush është të hyj kjo në rend dite për sot?

**Konstatojmë që nga 25 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 18 vota pro 5 kundër dhe 2 abstenime kjo pikë e propozuar hyn në rend dite për mbledhjen e sotme.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** vazhdojmë me propozimin tjetër ‘Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës e evidentuar sipas njësisë kadastrale nr. 500-0 ZK Bellopojë.Kush është të hyj kjo në rend dite për sot?

**Konstatojmë që nga 25 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 17 vota pro 5 kundër dhe 3 abstenime kjo pikë e propozuar hyn në rend dite për mbledhjen e sotme.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** vazhdojmë me propozimin tjetër ‘Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës e evidentuar sipas njësisë kadastrale nr. 373-0 ZK Kërrninë. Kush është të hyj kjo në rend dite për sot?

**Konstatojmë që nga 25 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 17 vota pro 5 kundër dhe 3 abstenime kjo pikë e propozuar hyn në rend dite për mbledhjen e sotme.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** vazhdojmë me propozimin tjetër ‘Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës e evidentuar sipas njësisë kadastrale nr. 499-0 ZK Bellopojë. Kush është të hyj kjo në rend dite për sot?

**Konstatojmë që nga 25 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 18 vota pro 5 kundër dhe 2 abstenime kjo pikë e propozuar hyn në rend dite për mbledhjen e sotme.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** vazhdojmë me propozimin tjetër ‘Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës e evidentuar sipas njësisë kadastrale nr. 1428-0 ZK Shushicë. Kush është të hyj kjo në rend dite për sot?

**Konstatojmë** që nga 25 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 17 vota pro 5 kundër dhe 3 abstenime kjo pikë e propozuar hyn në rend dite për mbledhjen e sotme.

**Kryesuesi i Kuvendit-** vazhdojmë me propozimin tjetër ‘Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës e evidentuar sipas njësisë kadastrale nr.368-0 Kërrminë.Kush është të hyj kjo në rend dite për sot?

**Konstatojmë** që nga 24 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 18 vota pro 5 kundër dhe 1 abstenim kjo pikë e propozuar hyn në rend dite për mbledhjen e sotme.

**Kryesuesi i Kuvendit-** vazhdojmë me propozimin tjetër ‘Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës e evidentuar sipas njësisë kadastrale nr. 541-0 ZK Veriq. Kush është të hyj kjo në rend dite për sot?

**Konstatojmë** që nga 24 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 18 vota pro 5 kundër dhe 1 abstenim kjo pikë e propozuar hyn në rend dite për mbledhjen e sotme.

**Kryesuesi i Kuvendit-** vazhdojmë me propozimin tjetër ‘Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës e evidentuar sipas njësisë kadastrale nr. 372-0 ZK Kërrninë. Kush është të hyj kjo në rend dite për sot?

**Konstatojmë** që nga 24 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 18 vota pro 5 kundër dhe 1 abstenim kjo pikë e propozuar hyn në rend dite për mbledhjen e sotme.

**Kryesuesi i Kuvendit-** vazhdojmë me propozimin tjetër ‘Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës e evidentuar sipas njësisë kadastrale nr. 1423-0 ZK Shushicë. Kush është të hyj kjo në rend dite për sot?

**Konstatojmë** që nga 24 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 18 vota pro 5 kundër dhe 1 abstenim kjo pikë e propozuar hyn në rend dite për mbledhjen e sotme.

**Kryesuesi i Kuvendit-** vazhdojmë me propozimin tjetër ‘Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës e evidentuar sipas njësisë kadastrale nr. 1420-0 ZK Shushicë .Kush është të hyj kjo në rend dite për sot?

**Konstatojmë që nga 24 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 18 vota pro 5 kundër dhe 1 abstenim kjo pikë e propozuar hyn në rend dite për mbledhjen e sotme.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** vazhdojmë me propozimin tjetër ‘Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës e evidentuar sipas njësisë kadastrale nr. 1424-0 ZK Shushicë .Kush është të hyj kjo në rend dite për sot?

**Konstatojmë që nga 24 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 18 vota pro 5 kundër dhe 1 abstenim kjo pikë e propozuar hyn në rend dite për mbledhjen e sotme.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** votojmë edhe për propozimin e drejtorit të drejtorisë për Shërbime Publike ‘Kérkesë për bartjen e pronësisë nga Komuna e Istogut te “KMDK SH.A / Kosovo Landfill” Prishtinë me qëllim të investimit të deponisë në Tuqep. Kush është të hyj kjo pikë në rend dite për sot?

**Konstatojmë që nga 24 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 19 vota pro 0 kundër dhe 5 abstenim kjo pikë e propozuar hyn në rend dite për mbledhjen e sotme.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** atëherë i kemi 15 (pesëmbledhjetë) pika të shtuara. Hedh në votim rendin e ditës për sot me propozimet e dhëna në tërësi, kush është të votohet rendi i ditës me këto propozime?

**Konstatojmë që nga 21 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 21 vota pro 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet rendi ditës për mbledhjen e sotme.**

### **Shqyrtimi i pikës 1.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** Në mbledhje mungon Njomza Demaj për shkaqe shëndetësore dhe Veton Kurti.

Të pranishëm në mbledhje janë 20 anëtarë të Kuvendit (disa prej tyre kanë lëshuar mbledhjen, disa të tjerë kanë dalë dhe kanë hyrë prapë).

### **Shqyrtimi i pikës 2.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** e hapi debatin në lidhje me procesverbalin nga mbledhja e kaluar? A ka dikush vërejtje apo sugjerime? Pasi që nuk ka diçka tjetër e hedh në votim kush është që të miratohet procesverbali nga mbledhja e kaluar?

**Konstatojmë që nga 20 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 18 vota pro 0 kundër dhe 2 abstenime miratohet procesverbali nga mbledhja e kaluar.**

#### **Shqyrtimi i pikës 3.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** fjalën e ka drejtori Genc Ademaj.

**Drejtori Genc Ademaj-** prezanton Qarkoren Buxhetore nr.1 të Ministrisë së Financave për kufijtë preliminar të përgatitjes së Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028.

**Niman Beqiraj-** te puna transportit, se e kam lexuar në terma që ministria e ka ndarë këtë Draft-Qarkoren Buxhetore transportin e nxënësve prej para fillores e deri në klasën e nëntë diku 3 milion e gjysmë. Dhe këtë pjesën për koston për paga përritjen e stafit 138, desha me pyet sa po na takojnë neve në këtë rastin e stafit edhe a ka shkuar kjo me planifikim paraprak, a kemi pasur ndonjë kornizë më të hershme e që tash na mbulon ministria. Nëse ti e përmende që nuk i mbulon taman pse nuk e bëjmë edhe një kërkesë shtesë që sipas këtij vendimi duhet me qenë e gjithë kosoto e mbuluar.

**Drejtori Genc Ademaj-** te kjo pjesa e politikës së re të arsimit, kam qenë anëtar i komisionit për ndarjen e granteve për nivelin lokal. Me short na ka rënë neve këtë vit si komunë edhe kemi pasur një takim shumë orësh me ministren e Arsimit, ministrisë së Shëndetësisë, Financave dhe pjesë të Departamenteve të buxhetit që merren me një analizë shumëvjeçare deri në një përfundim të caktuar vazhdimesht ka qenë kërkesë e jona që të mbulohet pjesa e arsimit kur e kemi dorëzuar edhe vitin e kaluar, por në pamundësi buxhetore nuk ka mundur të ekzekutohet për vitin 2025 por ka mbetur për vitin 2026. Kam këmbëngulur që kjo pjesë me ec si është komuna e Istogut, e ka distancën i ka specifikat e veçanta që patjetër duhet të futet në planifikim pjesa e organizimit të transportit për shkak edhe të rënies së numrit të nxënësve.

Vazhdon sqarimin dhe prezantimin e Qarkores.

**Kryesuesi i Kuvendit-** e hapim debatin rrëth kësaj pike. Pasi që nuk ka diçka, kjo nuk votohet është vetëm njoftim.

#### **Shqyrtimi i pikës 4.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** fjalën e ka drejtori Genc Ademaj.

**Drejtori Genc Ademaj-** një sqarim, ne kemi mbajtur edhe dëgjim publik, por realisht kjo është kërkuar si rregull sepse në bazë të Statutit të komunës as nuk ishte dashur të kaloj në Kuvend por me një aprovim nga kryetari, dërgohet në departamentin qendror për sistematizimin e vendeve të punës por MAPL-ja e ka dhënë si udhëzim që me kaluar përmes Kuvend për shkak të ligjshmërisë, kështu që nuk mendoj që Kuvendi duhet me e diskutuar pjesën e sistematizimit, besoj që secili zyrtar në bazë të akt emërimit i ka edhe të drejtat e veta që është i harmonizuar në bazë të katalogut të ri të vendeve të punës.

**Kryesuesi i Kuvendit-** fjalën e ka Arta Balaj.

**Arta Balaj-** unë e kam një kërkësë edhe një vërcjtje në lidhje me klasifikimin dhe sistematizimin e vendeve të punës për zyrtarët komunal. Lidhur me këtë kam disa vërejtje dhe propozime që deshiroj t'i parashtroj. Kam marrë vërejtje nga qytetarët, përfaqësues të shoqërisë civile dhe ekspertë të fushave përkatëse lidhur me konsultimin e paralajmëruar për datën 15 maj 2025 në ora 11:00. Sipas tyre ky konsultim nuk është realizuar në mënyrën e duhur pasi që personat përgjegjës për mbajtjen e tij nuk kanë qenë të pranishëm në sallë, duke pamundësuar pjesëmarrjen efektive dhe komunikimin e duhur. Sipas vërejtjes së ekpertëve të fushës juridike në secilën drejtori është e domosdoshme të ruhet pozita e zyrtarit të lartë ligjor dhe zyrtarit ligjor ashtu siç ka qenë më parë për të siguruar funksionalitet dhe përfaqësim brenda çdo drejtorie. Propozoj që të gjithë zyrtarët ligjorë të mbetin të sistematizuari në drejtorinë përkatëse sipas akt emërimeve ekzistuese pa rekrutime apo ndryshime të panevojshme. Gjithashtu në kuadër të zyrës ligjore propozoj të mbetet në udhëheqës i zyrës ligjore me dy zyrtarë ligjor për të garantuar kapacitete të plota dhe efikasitet në përbushjen e detyrave ligjore institucionale. Faleminderit për mirëkuptim dhe pres që këto vërejtje dhe propozime të merren parasysh.

**Genc Ademaj-** Arta, po të përgjigjëm edhe pse po më duket jo profesionale, dëgjimi është mbajtur ashtu siç e kemi potencuar edhe në mbledhjen e komitetit, zero interesim për qytetarët. Sepse qytetari nuk mundet me ardhë e me u angazhuar në sistematizimin e brendshëm sepse nuk e kuption edhe nuk është i thirrur për me e kuptuar. Dëgjimi është mbajtur për me i shfjerrë mundësitë që i ka dhënë MAPL-ja. E kemi thirrur dëgjinin, le që nuk ka pasur interesim nga qytetarët por as nga zyrtarët. Ta garantoj që secili zyrtar është i favorizuar me sistematizimin e vendeve të punës dhe katalogun e ri. Pse po e them këtë, sepse të gjithëve ju ngritet koeficienti përkundër që e kanë një akt emërim tjetër. Vazhdon sqarimin.

**Kryesuesi i Kuvendit-** a don me i hedh propozimet në votim.

Arta Balaj- po nëse është mundësia.

**Genc Ademaj-** ta dimë se çfarë po hedhim në votim, nuk mundesh me e hëdh një procedurë që është në kundërshtim me kompetencat dhe mundësitë. Ne jemi vetëm duke e shfrytëzuar një mundësi ligjore në bazë të një sistematizimi profesional për shkak të një rekomandimi që e ka bërë MAPL-ja vetëm sa e me përfunduar proceduralisht.

**Niman Beqiraj-** po pajtohem që askush më mirë se ti nuk i dinë punët e drejtorisë tënde, por te sistematizimi secili punëtor e ka një lloj përshkrimi të punës. Ky përshkrim i vendeve të punës është pikërisht për me e mbrojtur atë prej inateve personale, nuk po e them tuat por kushtimisht në përgjithësi, për këtë vjen edhe në Kuvend me u votuar, mendoj që është në rregull me u votuar prej Kuvendit. A ka pasur ankesa?

**Genc Ademaj-** nuk ka pasur ankesa, asnjë nuk ka qenë nga asnjë zyrtar. Nëse ne e marrim një vendim që është padrejtësi për secilin zyrtar brenda institucionit, është Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës që bën monitorim dhe auditim vjetor për komplet procedurat dhe gjithë procesin e gjithësecilit zyrtar publik që është këtu.

**Kryesuesi i Kuvendit-** Kuvendi nuk ka të drejtë që të ndërhyj në sistematizimin e vendeve të punës edhe të kësaj Rregullore. Ne mundemi me e votuar si akt procedural. Kush është për që të votohet kjo Rregullore?

**Konstatojmë që nga 20 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 18 vota pro 0 kundër dhe 2 abstenime miratohet Rregullorja për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Komunale.**

### **Shqyrtimi i pikës 5.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** drejtori Agon Dreshaj e ka fjalën.

**Agon Dreshaj-** prezanton pikën e rendit të ditës ‘Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim Vendimit për Destinimin e parcelës për varreza në fshatin Zhakovë.

**Kryesuesi i Kuvendit-** fjalën e ka Negjdet Ramaj.

**Negjdet Ramaj-** desha me e pyet drejtorin a është i informuar që ne në vitin 2023 me 31 janar saktë për fshatin Zhakovë lagjia “Ibrahimaj” dhe “Hajrizaj” e kemi votuar këtu në Kuvend e kemi destinuar një parcelë prej 90 ari, saktë atë pjesë ku po kërkohet prapë edhe atëherë e kanë nënshkruar qytetarët. Aty nuk është bërë asnjë investim, as nuk është pastruar tanë në tjetrën pjesë gjinden diku 40 ari nën rrugë, e kam diskutuar me disa banorë aty, banorët kanë pasur informacion, në petitionin e dytë që parcela prej 90 ari nuk është aprovuar në Kuvend edhe duhet përsëri me i përsëritur nënshkrimet për një parcelë për varreza. Ajo parcelë prej 90 ari ka nevojë shumë për pjesën e Zhakovës dhe një pjesë të mirë të Uçës se varrezat që kanë qenë më nuk ka vend, kështu që kjo pjesa proj 90 ari ju

kishte hy në punë lagjeve "Ibrahimaj" "Hajrizaj" dhe një pjesë të madhe të fshatit Uçë. Veç desha me ditë që a janë të informuar që 90 ari ne i kemi votuar për varreza e tani 20 ari nuk e di sa munden me ju hy në punë këtyre lagjeve.

**Agon Dreshaj-** Negjdet faleminderit për pyetjen! E di që e kemi votuar një parcelë për varreza në Zhakovë, për këtë arsyet jam interesuar edhe te zyra e Kuvendit. Por tani kemi një kërkesë tjetër me peticion për një parcelë tjetër, për këtë arsyet sa herë vjen kërkesa me peticion ne jemi të obliguar me e sjellë në Kuvend. Por kjo është destinimin, d.m.th me mundemi me e destinuar edhe këtë parcelë por në bazë të marrëveshjes së banorëve investimin për varreza mundemi me e bërë edhe në atë edhe në këtë. Nëse në të ardhmen nuk duan me e shfrytëzuar njëren për varreza e sjellim në Kuvend për anulim. Por kërkesa me ka ardhur prej 35 banorëve të nënshkruar me numra personal dhe me nënshkrime. Së pari kanë bërë kërkesë te Shërbimet Publike për rregullimin e varrezave pastaj e kemi ftuar atë në takim atë person që e ka bërë kërkesën për shkak se Shërbimet Publike nuk kanë munduar të ma kalojnë kompetencën për shkak se ne nuk vendosim për rregullim e pastaj e kanë ndërruar kërkesën e kanë bërë për destinimin e lokacionit të varrezave.

**Kryesuesi i Kuvendit-** fjalën e ka Negjdet Ramaj.

**Negjdet Ramaj-** ne atë pjesën e 90 ari as nuk e kemi pastruar edhe është shumë e përshtatshme për varreza e po kam frikë që mos po tenton dikush me e uzurpuar atë parcelë e me ja u dhënë 20 ari për varreza. Nëse është për me i shtuar edhe 20 ari unë jam 100% pro, por nëse kërkohet në të ardhmen me u shfuqizuar ai 90 ari e me lënë këtë 20 ari nuk jam për atë.

**Agon Dreshaj-** ne e kemi këtë kërkesë, nëse ne vendosim me e destinuar për varreza banorët kanë me e bërë një kërkesë për rregullimin e hapësirës së varrezave, tani nëse ka marrëveshje që në një vend me u bërë varrezat me investuar drejtoria e Shërbimeve Publike për rregullimin e tyre atëherë këtë parcelën tjetër që mbetet mundemi me e sjellë në Kuvend me e anuluar.

**Kryesuesi i Kuvendit-** Negjdet Ramaj e ka fjalën.

**Negjdet Ramaj-** nuk jam asgjë kundër, mirëpo kjo pjesa 20 ari që po kërkohet tani kjo është e ndarë prej asaj 90 ari. Unë vetëm desha me e ditë arsyen edhe mos drejtori është i keq informuar për këtë pikë të rendit të ditës. Nëse ne nuk kemi investuar asgjë tek ajo parcella 90 ari e po vazhdojmë tutje te një parcelë tjetër prej 20 ari po më duket shumë e pakuptimtë.

**Kryesuesi i Kuvendit-** fjalën e ka Hajrush Shoshi.

**Hajrush Shoshi-** unë mendoj që të dy parcelat prapë mbeten pronë komunale, edhe nëse japat për varreza nuk mund të shfrytëzohet për diçka tjetër.

**Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Andi Xhuraj.**

**Andi Xhuraj-** po i bashkëngjitem shqetësimit të Negjdetit sepse neve ne po vendosim me ja u dhënë edhe një parcelë tjetër prej 20 ari ajo të paktën duhet me qenë ngjitur me të, sepse kjo parcela që e kemi votuar ne vitin e kaluar është në anën tjetër e kjo tjetra anën tjetër nuk ka logjikë sepse i ndan rruga, janë larg njëra nga tjetra.

**Kryetari i Komunës-** ndoshta mund të jetë e mundshme që duan ti ndajnë varrezat, dy tri lagje të caktuara Andi edhe Negjdet, me supozime po flas, ne nuk po ja u japim në shfrytëzim pronën, jemi duke e destinuar për varreza. Nuk e besoj që nëse janë 35 ( tridhjetë e pesë qytetarë) që e kanë marrë iniciativën për me e nënshkruar një petition nuk e kanë bërë kot atë. Ndoshta parcela tjetër është si konfiguracion i papërshtatshëm Negjdet. Tani nga mesi i qershorit janë dëgjimet publike, e hapim si temë me qytetarët dhe e diskutojmë, nuk po e shoh të nevojshme me ngrit dyshime që nëse destinohet diçka për varreza të prodhoj diçka tjetër.

**Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Negjdet Ramaj.**

**Negjdet Ramaj-** pse nuk kemi kërkesë për shfuqizimin e vendimit të 31 janarit të 2023, për atë e ngrita si shqetësim. Se unë jam për me ja u dhënë atë tokë se kanë nevojë.

**Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Niman Beqiraj.**

**Niman Beqiraj-** pasi që prapë është në pikëpyctje, e kemi votuar një pjesë tanë po duhet me u votuar prapë, ndoshta më mirë kishte qenë me qenë të sigurt se cilën pjesë po duam ta destinojmë, me e mbajtë ndonjë dëgjim publik atje me qytetarët e Zhakovës, në mënyrë që ne me ditë saktë se çka kemi me destinuar. Unë nuk jam kundër me e destinuar tokën sepse e kemi edhe obligim për me e dhënë atë pjesë, por mos me krijuar ne precedent të keq. Ne i kemi disa varreza publike, i kemi vendosur 90 ari, kjo veç duhet me qenë pak e qartë, nuk jemi kundër por informata dhe qartësi po kërkojmë.

**Naim Behlulaj-** sipas informatave që unë i kam, pjesa që është destinuar më herët është e papërshtatshme për vendosjen e varrezave, aty Negjdeti e di që është shumë te poshtë dhe duhet investim i madh, atë e kanë propozuar bashkërisht Uça dhe Zhakova, tanë kur e kanë parë që duhet investim i madh dhe me mjete vetanake dhe nuk mundem me e bë e kanë kërkuar pjesën tjetër. Kjo ka qenë kërkesa sipas informatave që unë i kam.

**Niman Beqiraj-** ti je duke folur në kuptimin e investimit të qytetarëve me mjete të veta apo të komunës, sepse normal komuna varrezat publike duhet me i investuar si i ka investuar në Vrellë duhet edhe në Zhakovë.

**Kryetari i Komunës-** është më e thjeshtë dhe më pak e kushtueshme me e ndarë një parcelë tjetër se sa me insistuar me vendimin e Kuvendit që me investuar përkundër që kushton trefish me shtrenjtë.

**Niman Beqiraj-** unë jam ashtu siç po thua ti. Por më mirë është të planifikohet më herët.

**Kryesuesi I Kuvendit-** fjalën e ka Haki Podrimaj.

**Haki Podrimaj-** po inkuadrohem cdhc unë për shkak se mandatin e kaluar e kemi pasur të njëjtën temë për Vrellë. Ja u kemi ndarë një pjesë por pas një kohe nuk janë pajtuar dhe e kanë kérkuar një tjetër pjesë. Ja u kemi ndarë edhe tjetrën pjesë kur kanë filluar atë tjetrën e kemi shfuqizuar. Mos ta dramatizojmë, unë kérkoj nga përfaqësuesit e mbi vadës të merren vesh me një propozim se cilën pjesë e duan për varreza dhe tjetrën ta shfuqizojmë.

**Kryesuesi i Kuvendit-** ne po votojmë. Po ja u japim, e pastaj shohim se çfarë po ndodhë. Fjalën e ka Florin Dreshaj.

**Florin Dreshaj-** kjo kérkesa që është bërë për këtë pjesën që po mundohemi me ja dhënë në shfrytëzim, nuk jam kundër, a është bërë kérkesa prej ndonjë lagje apo ka me u shfrytëzuar nga i gjithë fshati? Se 20 ari janë pak.

**Kryesuesi i Kuvendit-** nga i gjithë fshati. Fjalën e ka Ajshe Metaj.

**Ajshe Metaj-** sa i përket sipërfaqes që na ja u kemi ndarë këtu që është ajo sipërfaqja me e madhe 90 ari dhe në krahasim me këtë 20 ari që po e kérkojnë për tërë fshatin, ajo sipërfaqe nuk ju mjafton se mbushet shpejt se njerëzit vdesin normal. Çështja është a po ju bëhet një zgjidhje e përhershme, u arsyetua dhe me vëmendje dëgjova se konfiguracioni nuk ka qenë i përshtatshëm, por me e krahasuar me këtë 20 ari me atë 90 ari nuk i plotëson kushtet dhe unë po mendoj që nuk është se po zgjidhet përgjithmonë kjo çështje.

**Kryesuesi i Kuvendit-** fjalën e ka drejtori i Kadastrës për një sqarim.

**Agon Dreshaj-** 20 ari është kérkesë e banorëve, a shumë a pak është kérkesë e banorëve. Ta destinojmë këtë parcelë për varreza edhe ajo prej 90 ari është e destinuar, le te merren vesh banorët mes veti, javën e ardhshme i pres në zyrë dhe atë që nuk duan e sjellim për shfuqizim mbledhjen e ardhshme.

**Kryesuesi i Kuvendit-** në rregull. I morëm informatat, po votojmë.

**Konstatojmë** që nga 22 anëtarë të Kuvendit me 21 vota pro 0 kundër dhe 1 abstenim miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

### **Shqyrtimi i pikës 6.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** fjalën e ka drejtori Abedin Kabashi.

**Abedin Kabashi-** prezanton pikën e rendit te ditës.

**Kryesuesi i Kuvendit-** fjalën e ka Drita Pinaj, përfaqësuesja e GIZ-it në Kosovë.

Drita Pinaj- jep një prezantim dhe falenderim.

**Kryesuesi i Kuvendit-** me duhet të jap një sqarim se mua me ka ardhur pika si shqyrtim dhe miratim i Planit por në fakt është për Dëgjim Publik, pra është shpallja në Dëgjim Publik e Planit. Kush është të shkoj në diskutim publik ky Plan?

**Konstatojmë** që nga 19 anëtarë të Kuvendit me 19 vota pro 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

### **Shqyrtimi i pikës 7.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** fjalën e ka drejtori Genc Ademaj.

**Genc Ademaj-** prezanton pikën e rendit të ditës.

**Kryesuesi i Kuvendit-** e hapi debatin, a ka dikush diçka? Pasi që jo, kush është të votohet kjo listë?

**Konstatojmë** që nga 19 anëtarë të Kuvendit me 19 vota pro 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet kjo pikë e rendit te ditës.

### **Shqyrtimi i pikës 8.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** po vazhdojmë me pikat që janë propozuar. Po vazhdojmë me pikën që e ka propozuar Floriana. Po e ftoj drejtorin Genc Ademaj, që ta jap një sqarim sepse kjo ka implikime.

**Genc Ademaj-** lidhur me propozimin e Florianës ne u konsultuam se patëm hapësirë, vetëm le të evidentohet që është Plotësim Ndryshim i Rregullores për Taksa Ngarkesa dhe Gjoba, me theks të vecantë lirimi i pjesëtarëve të zjarrëfiksëve nga shërbimet e shëndetit primar në komunën e Istogut. Që nënkupton të gjitha pagesat që i kanë në QKMF.

**Kryesuesi i Kuvendit-** në rregull po votojmë. Kush është për?

**Konstatojmë që nga 17 anëtarë të Kuvendit me 17 vota pro 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet propozimi i anëtares së Kuvendit znj. Floriana Maxharraj.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** fjalën e ka Florin Dreshaj.

**Florin Dreshaj**-ishim duke diskutuar iniciativën që Floriana e ka marrë, kemi dashur edhe FSK-ja.

**Kryesuesi i Kuvendit-** më së paku ka nga Istogu në FSK, ata në bazë e kane mjekun e vet.

**Shqyrtimi i pikës 9.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** e hapi debatin lidhur me këtë pikë. Fjalën e ka Florin Dreshaj.

**Florin Dreshaj**- unë propozova më herët që me na u dhënë një kohë me i lexuar këto, the që flasim kur të vijmë te ajo pikë. Nuk kemi pasur mundësi me i lexuar dhe nuk po jemi në gjendje me votuar për apo kundër.

**Kryesuesi i Kuvendit-** jemi në këtë situatë Florin, ju kisha lutur për mirëkuptim, se vëllimi i punës që e kemi përpara është mjaft i madh.

**Florin Dreshaj**- ne e morëm materialin tani, nuk po kemi mundësi, nuk kemi informacion, nuk mund ta marrë përsipër një obligim kur nuk e di se çka po votoj.

**Kryesuesi i Kuvendit-** po i diskutojmë pa nguti dhe e hapi debatin. Fjalën e ka Agron Gashi.

**Agron Gashi**- ne nuk kemi qenë kundër këtyre, kemi qenë vetëm kundër procedurave, përndryshe gripi jonë jemi pro këtyre vendimeve, këtyre nismave që i hapin rrugë investimit në komunën tonë.

**Kryesuesi i Kuvendit-** prapë po ju kërkoj për mirëkuptim. Fjalën e ka Hajrush Shoshi.

**Hajrush Shoshi**- desha pak të diskutoj rreth këtyre propozim vendimeve, te disa e pashë që është vlera financiare e te disa të tjera jo, mirëpo kemi edhe raste ku vlera financiare është e paraqitur e njëjtë që i ka tri apo katër parcela një kompani, e këtu ose duhet me e ndarë në bazë të proporcionit të parcelave për metër katrorë dhe me e cek në propozim vendim vetëm vlerën që është nga ai investim d.m.th mos të mbetet, ose të hiqet krejt në të gjitha vlera financiare ose të jetë në të gjitha.

**Kryesuesi i Kuvendit-** çfarë po propozon konkretisht.

**Hajrush Shoshi-** konkretisht që këto të mbesin sipas planit investiv dhe projektit ideor që e ka bërë. Ta heqim këtë vlerën financiare për të gjitha ose ta gjejmë për të gjitha me e pasur një vlerë.

**Kryetari i Komunës-** po e kuptoj shqetësimin e Hajrushit, po supozoj që jam operator ekonomik dhe kam aplikuar për 100 hektarë, në aplikim e kam paraqitur që vlerën investive për 100 hektarë me e bërë 100 milionë euro. Komisioni e ka vlerësuar që në një pjesë të parcelave që kam aplikuar, Hajrushi ka vënë interes publik më të madh se unë dhe mua më kanë shpërblyer me 60 hektarë dhe tani e njëjtë vlerë e investimit e paraqitur sepse operatori ka aplikuar për 100 hektarë. Momentin që vijmë te fazë e nënshkrimit të kontratës, kjo sigurisht përpjesëtohet për metrat katrore, që i merr në shfrytëzim. Për të tjerat përgjigjet drejtori.

**Agon Dreshaj-** ne e kemi pasur edhe një diskutim në Komitetin për Politikë dhe Financa, për këtë cështje, pasi i kemi analizuar propozim vendimet, konsideroj që është i drejtë propozimi edhe mundemi që në pikën e tretë të propozim vendimit, që është interes publik i Komunës d.m.th që ta lëmë sipas projektit ideor edhe planit të biznesit pastaj përpjesëtohen ashtu siç e tha edhe kryetari. Po ashtu edhe një rekomandim ka ardhur edhe nga anëtarja e Kuvendit znj. Ajshe Metaj gjithashtu në KPF, që pasi në thirrje ka qenë e përcaktuar 30 vite, edhe në vendim të jetë e cekur periudha kohore prej 30 vitesh pasi që në propozim vendim është vetëm afatgjatë. Pajtohem që këto rekomandime të janë pjesë e të gjitha vendimeve.

**Kryesuesi i Kuvendit- Hajrush si do ta formulosh atë që e the?**

**Hajrush Shoshi-** që vlera investive të jetë sipas planit të biznesit dhe projektit ideor dhe me u heq pjesa financiare.

**Genc Ademaj-** tc pika tre unë kisha jep si rekomandim, të jetë ky formulim, hapi i parë propozimi i profesoreshes Ajshe që të jetë e cekur periudha prej 30 vitesh dhe te pjesa tjeter të jetë që projekti ose parcela, të jete e harmonizuar me projektin ideor, pse po e them këtë? Ne që kemi qenë anëtarë të komisionit vlerësues, secili investitor i ka ndarë parcelat brenda projekteve të tyre ideore pastaj i përgjigjet edhe marrjes në shfrytëzim të asaj parcele.

**Kryesuesi i Kuvendit-** të bëhet ky formulim dhe inkorporim i propozimeve të Ajshes dhe Hajrushit. Pra kjo bazë ligjore i prek të gjitha këto propozim vendime. Fjalën e ka Florin Dreshaj.

**Florin Dreshaj-** kolegu Hajrushi i ka pasur këto se është në Komitet për Politikë dhe Financa, dhe paska pasur kohë me i shikuar dhe po shihet që janë bërë shpejt e shkel e shko, dhe nuk mundem këtu me marrë vendim me votuar as pro as kundër e me i hyrë në hak as atyre që kanë aplikuar për këtë punë edhe nuk jemi

në kundër zhvillimit ekonomik por në këtë mënyrë nuk mundem me marrë vendime, kështu që vazhdo.

**Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Hajrush Shoshi.**

**Hajrush Shoshi-** unë mendoj që këtu nuk ishte dashur më të diskutohet, edhe thirrja publike është që të bëhen investimet në energji të ripërtritëshme. Gjasat janë që ndoshta ndonjë operatorë mos ta marrë fare lejen për me prodhuar, por investimet që shihen prej operatorëve ekonomikë janë jashtëzakonisht të mëdha dhe përfitimi është i madh i komunës dhe ne është mirë që ta hapim derën e të bëhen këto investime dhe kërkoj të votohen.

**Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori Genc Ademaj.**

**Genc Ademaj-** jep sqarim shtesë.

**Kryesuesi i Kuvendit- fjalen e ka Niman Beqiraj.**

**Niman Beqiraj-** prej kësaj kohe shkurt çfarë kam mundur të lexoj, te këto propozime, secila e ka të shkruar investim strategjik, tanë cfarë nënkuuptojmë ne me investim strategjik? As këtë informatë bazike nuk e kemi. Ne nuk jemi kundër dhe ne jemi pro me u investuar dhe me pas zhvillim ekonomik, çështja te kjo pikë nuk është asnjëherë për apo kundër, por me pas me shumë informata se nuk kemi. Për asnjë nga këto kompani nuk kam informata kush është sa ka pas qarkullim, tanë vendimi është i asamblesë, kur ta marrësh një vendim duhet me qenë më i sigurt se çka po voton, është pronë komunale , kemi me ja dhënë dikujt, por investim strategjik me 10 vende pune, nuk po e di që ka dikund. Te unë ka dyshime.

**Kryesuesi i Kuvendit- fjalen e ka Kryetari i Komunës.**

**Kryetari i Komunës-** nganjëherë e kam përshtypjen se e kcukuptojmë rolin të cilin e kemi dhe nuk e kuptojmë kompetencën dhe të drejtën. E para, ligjëvënesi e ka përcaktuar saktë, nëse ai kishte menduar se ka bazë për dyshime, 120 deputetë, e kishte fut të gjithë asamblenë në komision, por e ka përcaktuar në bazë të fuqisë politike, një nga shumica, tjetra prej partisë së dytë më të madhe që është në Kuvend, përtej kësaj prej ekzekutivit dhe shoqërisë civile është mix i njerëzve që mendojnë ndryshc politikisht njëri nga tjetri. Dhe duke e ditur që ky Kuvend e ka ngrit dorën për me e votuar këtë komision është totalisht politikisht absurde. Nuk po vlerësojmë tender, nuk jemi ekspertë të energjisë me vlerësuar cila kompani është më e favorshme, termin investim strategjik e përcakton ligji Niman, në bazë të shumës së investimit.

**Kryesuesi i Kuvendit- replikë Niman Beqiraj.**

**Niman Beqiraj-** kryétari e shpjegoi në formën e vet por prapë nuk ë ka kuptuar se çfarë kam dashur të them. Unë e kam çështjen e dokumentave. Unë këtu e kam një emër që nuk kam informata për të. Nuk po them as që jeni të mirë as të këqinjë por po mungon si informatë. Dhe duke qenë si e tillë unë nuk po e di a është mirë me vendos për apo kundër.

**Kryesuesi i Kuvendit-** atëherë po e hedh në votim, kush është të votohet kjo pikë e rendit të ditës me rekomandimet që i kanë dhënë anëtarët e Kuvendit, Hajrush Shoshi dhe Ajshe Metaj pra po e ceku që këto rekomandime janë për të 13 (trembëdhjetë) këto propozim vendime, por kohë pas kohe do e ceku edhe në pikat e tjera. Kush është për?

**Konstatojmë** që nga 18 anëtarë të Kuvendit me 15 vota pro 0 kundër dhe 3 abstenime miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

#### **Shqyrtimi i pikës 10.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** e hapi debatin, pasi që nuk ka dikush diçka, atëherë po e hedh në votim, kush është të votohet kjo pikë e rendit të ditës me rekomandimet që i kanë dhënë anëtarët e Kuvendit, Hajrush Shoshi dhe Ajshe Metaj. Kush është për?

**Konstatojmë** që nga 18 anëtarë të Kuvendit me 15 vota pro 0 kundër dhe 3 abstenime miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

#### **Shqyrtimi i pikës 11.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** e hapi debatin, pasi që nuk ka dikush diçka, atëherë po e hedh në votim, kush është të votohet kjo pikë e rendit të ditës me rekomandimet që i kanë dhënë anëtarët e Kuvendit, Hajrush Shoshi dhe Ajshe Metaj. Kush është për?

**Konstatojmë** që nga 18 anëtarë të Kuvendit me 15 vota pro 0 kundër dhe 3 abstenime miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

#### **Shqyrtimi i pikës 12.**

**Kryesuesi I Kuvendit-** e hapi debatin. Fjalën e ka Niman Beqiraj.

**Niman Beqiraj-** këtu po thuhet që ka me u ndërtuar një çerdhe dhe pata dëshirë me e ditur a e kemi të përcaktuar se ku do të ndërtohet? Lokacionin, a është projekt, pra me pas më shumë informata. Dhe mos marrja pjesë e grupit tonë në votime, nënkupton si pasojë e mungesës së informatave që i kemi na për secilën nga këto. Për këtë nuk dëshirojmë të jemi pjesë e këtyre votimeve.

**Kryesuesi i Kuvendit- fjalën'e ka drejtori Genc Ademaj.**

**Genc Ademaj-** Niman te kjo pjesë, mbetet te kushtet e veçanta të kontratës, e kemi diskutuar gjatë me komisionin dhe e kemi marrë një vendim unanimisht që me u ruajt interesit kryesor publik, ndërtimi i çerdhes, madhësia dhe forma përcaktohet në kontratën që nënshkruhet pas konfirmimit të ligjshmërisë. P.sh nëse në Istog që 100% ka nevojë edhe për katër çerdhe shtesë, atëherë e gjejmë një lokacion të përshtatshëm vendosim bashkë për përcaktimin se shkon përmes Kuvendit.

**Niman Beqiraj-** ju e dini që e kemi pasur edhe një rast kur e kemi bërë këmbimin e pronës me interes publik dhe kanë qenë shumë dokumente që është dashur të kërkohen, c' tani asnjë nga ato unë nuk i kam këtu. Këtu është problemi, a me i besuar unë atij që i ka paret me e bërë këtë.

**Genc Ademaj-** ajo tani është përgjegjësi e komisionit. Se ne i kemi përcaktuar kriteret te thirrja publike. Një operator është përjashtuar për shkak se nuk e ka pasur dokumentacionin sipas thirrjes publike. Ka pasur edhe raste të tilla, për këtë kjo është përgjegjësi e komisionit.

**Kryesuesi i Kuvendit-** e hapi debatin, pasi që nuk ka dikush diçka, atëherë po e hedh në votim, kush është të votohet kjo pikë e rendit të ditës me rekomandimet që i kanë dhënë anëtarët e Kuvendit, Hajrush Shoshi dhe Ajshe Metaj. Kush është për?

**Konstatojmë që nga 18 anëtarë të Kuvendit me 15 vota pro 0 kundër dhe 3 abstenime miratohet kjo pikë e rendit të ditës.**

**Shqyrtimi i pikës 13.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** e hapi debatin, pasi që nuk ka dikush diçka, atëherë po e hedh në votim, kush është të votohet kjo pikë e rendit të ditës me rekomandimet që i kanë dhënë anëtarët e Kuvendit, Hajrush Shoshi dhe Ajshe Metaj. Kush është për?

**Konstatojmë që nga 18 anëtarë të Kuvendit me 15 vota pro 0 kundër dhe 3 abstenime miratohet kjo pikë e rendit të ditës.**

**Shqyrtimi i pikës 14.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** e hapi debatin, pasi që nuk ka dikush diçka, atëherë po e hedh në votim, kush është të votohet kjo pikë e rendit të ditës me rekomandimet që i kanë dhënë anëtarët e Kuvendit, Hajrush Shoshi dhe Ajshe Metaj. Kush është për?

**Konstatojmë që nga 18 anëtarë të Kuvendit me 15 vota pro 0 kundër dhe 3 abstenime miratohet kjo pikë e rendit të ditës.**

**Shqyrtimi i pikës 15.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** e hapi debatin, pasi që nuk ka dikush diçka, atëherë po e hedh në votim, kush është të votohet kjo pikë e rendit të ditës me rekondimimet që i kanë dhënë anëtarët e Kuvendit, Hajrush Shoshi dhe Ajshe Metaj. Kush është për?

**Konstatojmë që nga 18 anëtarë të Kuvendit me 15 vota pro 0 kundër dhe 3 abstenime miratohet kjo pikë e rendit të ditës.**

**Shqyrtimi i pikës 16.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** e hapi debatin, pasi që nuk ka dikush diçka, atëherë po e hedh në votim, kush është të votohet kjo pikë e rendit të ditës me rekondimimet që i kanë dhënë anëtarët e Kuvendit, Hajrush Shoshi dhe Ajshe Metaj. Kush është për?

**Konstatojmë që nga 18 anëtarë të Kuvendit me 15 vota pro 0 kundër dhe 3 abstenime miratohet kjo pikë e rendit të ditës.**

**Shqyrtimi i pikës 17.**

**Kryesuesi I Kuvendit-** e hapi debatin. Fjalën e ka Niman Beqiraj.

**Niman Beqiraj-** e kam një pyetje për drejtorin e Zhvillimit Ekonomik, me shtatë vende pune a cilësohet investim strategjik?

**Genc Ademaj-** shtatë vende të punës e shikon madhësinë e parcelës, vlerën investive edhe stafi real, ai ka mundur me i shkruajtur edhe njëqind vende por ka qenë i saktë dhe e ka potencuar se për çka janë ato shtatë vende të punës. Cilësohet, çdo vend pune cilësohet.

**Kryesuesi i Kuvendit-** e hapi debatin, pasi që nuk ka dikush diçka, atëherë po e hedh në votim, kush është të votohet kjo pikë e rendit të ditës me rekondimimet që i kanë dhënë anëtarët e Kuvendit, Hajrush Shoshi dhe Ajshe Metaj. Kush është për?

**Konstatojmë që nga 18 anëtarë të Kuvendit me 15 vota pro 0 kundër dhe 3 abstenime miratohet kjo pikë e rendit të ditës.**

**Shqyrtimi i pikës 18.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** e hapi debatin, pasi që nuk ka dikush diçka,atëherë po e hedh në votim, kush është të votohet kjo pikë e rendit të ditës me rekondimet që i kanë dhënë anëtarët e Kuvendit, Hajrush Shoshi dhe Ajshe Metaj. Kush është për?

**Konstatojmë që nga 18 anëtarë të Kuvendit me 15 vota pro 0 kundër dhe 3 abstenime miratohet kjo pikë e rendit të ditës.**

#### **Shqyrtimi i pikës 19.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** e hapi debatin, pasi që nuk ka dikush diçka,atëherë po e hedh në votim, kush është të votohet kjo pikë e rendit të ditës me rekondimet që i kanë dhënë anëtarët e Kuvendit, Hajrush Shoshi dhe Ajshe Metaj. Kush është për?

**Konstatojmë që nga 18 anëtarë të Kuvendit me 15 vota pro 0 kundër dhe 3 abstenime miratohet kjo pikë e rendit të ditës.**

#### **Shqyrtimi i pikës 20.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** e hapi debatin, pasi që nuk ka dikush diçka,atëherë po e hedh në votim, kush është të votohet kjo pikë e rendit të ditës me rekondimet që i kanë dhënë anëtarët e Kuvendit, Hajrush Shoshi dhe Ajshe Metaj. Kush është për?

**Konstatojmë që nga 18 anëtarë të Kuvendit me 15 vota pro 0 kundër dhe 3 abstenime miratohet kjo pikë e rendit të ditës.**

#### **Shqyrtimi i pikës 21.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** e hapi debatin, pasi që nuk ka dikush diçka,atëherë po e hedh në votim, kush është të votohet kjo pikë e rendit të ditës me rekondimet që i kanë dhënë anëtarët e Kuvendit, Hajrush Shoshi dhe Ajshe Metaj. Kush është për?

**Konstatojmë që nga 18 anëtarë të Kuvendit me 15 vota pro 0 kundër dhe 3 abstenime miratohet kjo pikë e rendit të ditës.**

#### **Shqyrtimi i pikës 22.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** e hapi debatin, pasi që nuk ka diskutime. E hedh ne votim kush është të miratohet ky propozim vendim?

**Konstatojmë që nga 18 anëtarë të Kuvendit me 15 vota pro 0 kundër dhe 3 abstenime miratohet kjo pikë e rendit të ditës.**

### **Shqyrtimi i pikës 23.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** fjalën e ka Niman Beqiraj.

**Niman Beqiraj-** një pyetje për kryetarin. Një marrëveshje që e ke bërë me KRM "Ambienti" me 12 Mars 2025 është në vlerë prej 480 mijë euro, e cila përfshin grumbullimin, transportin e mbeturinave, pastrimin, mirëmbajtjen e rrugëve, hapësirave publike, mirëmbajtjen e varrezave, kjo mirë që është bërë, por pata dëshirë me ditë a është kjo shifër për 4 vite apo për 1 vit, për sa kohë përfshinë kontrata. Dhe të kjo çështja e varrezave publike ende nuk e kam parë që kanë filluar me u mirëmbajtur, kush ka me i mbikëqyrur inspektorët a kush, me e ditë se a po kryhen punët, meqë ne e dimë që edhe çmimi i mbeturinave është rritur. Nuk e di a është dashur të vijë përmes Kuvendit kjo marrëveshja që e keni bërë.

**Kryesuesi i Kuvendit-** Niman të kërkoj falje por më duhet me e mbyllë mbledhjen për shkak se nuk e kemi kuorumin e nevojshëm.

**Kryetari i Komunës-** Niman marrëveshja me KRM "Ambienti" është kontratë në shtëpi që e parasheh Ligji i Prokurimit Publik. Kontrata ka menaxher kontrate, ka varreza që kanë filluar të pastrohen.

**Kryesuesi i Kuvendit-** e shpallë të mbyllur mbledhjen e sotme. Falënderon të gjithë për durimin qe patën, dhe kontributin e dhënë, Faleminderit për pjesëmarrje, mirupafshim në mbledhjet e tjera.

**Mbledhja përfundoi me punë në ora 13:00**

Procesmbajtëse,  
Flora Bujupaj

Kryesues i mbledhjes,  
Enver Rugova

